

Intervistë e albanologut të njohur Robert Elsie

TASHMË SHQIPTARËT JANË QYTETARË TË EVROPËS

Për ta prezantuar bashkëbiseduesin tonë, Robert Elsie, nuk duhen shumë fjalë. Ai ka vite që është shumë i njohur për opinionin shqiptar, sidomos pas botimit të “Historisë së Letërsisë Shqiptare,” vepër kjo që për shumëçka mund të quhet botimi më i plotë dhe më objektiv i historisë sonë të letërsisë. Në dhjetor të vitit 2000, Robert Elsie është zgjedhur anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Fletëdëshmia iu nda javën që shkoi, gjatë një solemniteti të organizuar enkas për të. Elsie more pjesë edhe në punimet e Seminarit XX Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare, në të cilin paraqiti kumtesën “Stuart Mann - historiani i parë anglisht i letërsisë shqiptare.” Këto dhe çështje të tjera janë prekur në këtë intervistë, por e veçanta e saj padyshim është një zbulim i ri që ka bërë Elsie - dorëshkrimi më i vjetër i një historie të Shqipërisë. Intervistën për “Botën Sot” Elsie e dha pak orë para se të udhëtonte për në Gjermani, ku jeton ky albanolog i shquar nga Kanadaja.

Bota Sot: *Z. Elsie këto ditë ju morët Fletëdëshminë e pranimit anëtar i jashtëm i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës. Si e përjetuat këtë akt?*

Robert Elsie: Për mua pranimi në ASHAK është një nder i madh. Shpresoj se me punën time në të ardhmen do ta arsyetoj këtë mirënjohje që më është dhënë nga institucioni më i lartë shkencor i Kosovës.

Bota Sot: *Ka vite që ju jeni pjesëmarrës pothuajse i rregullt i Seminarit për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare. A keni vërejtur ndonjë ndryshim midis panairëve të mëparshme dhe këtij të sivjetshmit?*

Robert Elsie: Në Kosovë kam qenë për herë të parë në vitin 1979, kur fillova të mësoj shqipen në kurset e gjuhës shqipe për të huajt. Në seminar isha edhe gjatë vitëve të tetëdhjeta, ndërsa pas çlirimit kam qenë në Kosovë në gusht të vitit 1999. Natyrisht, kam marrë pjesë edhe në Seminarin e vitit 2000.

Sa i përket Seminarit XX mund të them se ai, pak a shumë, ishte i njëjtë me ata pararendësit. Cilësia e kumtesave të lexuara ne Seminarin XX ishte e ndryshme. Disa kumtesa ishin shumë të mira, por kishte edhe aso që vërtet ishin shumë të dobëta. Por, kryesorja është se, gjatë këtyre ditëve sa zgjati Seminari, Prishtina ishte një pikëtakim i rëndësishëm i albanologëve nga mbarë bota.

Megjithatë, një gjë më shqetëson mua: seminaristët, veçanërisht ata nga Shqipëria edhe kësaj here ishin kryesisht të moshuar. Mendoj se po të vazhdojë kështu, albanologjia do të jetë si Kisha katolike, në të cilën priftërinj nën moshën 80 vjeç nuk ka më.

Në Tiranë beteja për albanologjinë është humbur!

Bota Sot: *Në Kosovë ka studiues të rinj, sidomos në fushë të letërsisë, që përveç talentit kanë dëshmuar edhe një seriozitet të lartë në punë të hulumtimit shkencor. Mirëpo, këta studiues, që pa dyshim do të jenë e ardhmja e studimeve albanologjike te ne, nuk u paraqitën në këtë seminar. Ç'është ky hezitim apo mosinteresim i tyre për të marrë pjesë drejtpërdrejt në punimet e Seminarit?*

Robert Elsie: Duhet të inkurajohen studiuesit e rinj që të marrin pjesë në mënyrë aktive në jetën albanologjike, madje jo vetëm në kuadër të Seminarit, në mënyrë që shkencat albanologjike të mos zhduken. Kjo mund të bëhet para së gjithash në Prishtinë, ku ka edhe vullnet, edhe kapacitet të ri për studime cilësore në këtë fushë, sepse në Tiranë beteja është humbur, ngase brezi i ri nuk ka fare interesim për albanologjinë. Shqipëria vuan shumë nga ikja e trurit dhe nuk ka përgatitur kurrë një brez tjetër, që do ta zëvendësonte atë të epokës së paraviteve '90.

Bota Sot: *Si në Shqipëri, ashtu edhe në Kosovë, albanologët përgjithësisht janë formuar përbrenda sistemit arsimor socrealist. Gjurmët e "mësimeve" të atij sistemi hetohen ende në studimet albanologjike. Si të dilet nga kjo gjendje?*

Robert Elsie: Është domosdoshmëri që më shumë shqiptarë të rinj të shkojnë jashtë për specializim, dhe kjo vlen edhe për shkencat albanologjike. Këta të rinj, specialistë të ardhshëm, do t'i sillnin dijet e përfituara nëpër qendrat e jashtë universitare në vendin tuaj dhe kështu do të kontribuonin shumë për ngritjen e cilësisë së arsimit dhe të shkencës suaj.

Por, ka një problem në këtë drejtim. Për shembull, në Gjermani, ku jetoj unë, qevëria gjermane pati nënshkruar një marrëveshje për punë me autoritetet shqiptare, e cila përfshinte një varg studiuesish të rinj, të cilët duhet të specializonin atje dhe mandej të ktheheshin në Shqipëri. Por, nga ky program asnjë shqiptar nuk u kthye në Shqipëri, prandaj qevëria gjermane e ka pezulluar fare marrëveshjen në fjalë. Fatkeqësisht, gjendja është njësoj edhe me bursat e specializimit. Shumë studentë nuk kthehen pas specializimit, kështu që numri i bursave është shumë i kufizuar.

Situata në Kosovë është më e mirë, sepse këtu ka një vullnet më të madh për t'u kthyer dhe për të ndërtuar vendin, i cili, pas shumë dekadash, më në fund, është i lirë.

Po përgatis Historinë e parë të Shqipërisë, të shkruar frëngjisht më 1884.

Bota Sot: *Mbase nuk do të ishte e paqëlluar sikur të tregonit për lexuesit tanë çka ju shtyri të merreni kaq intensivisht me shqiptarët dhe kulturën e tyre?*

Robert Elsie: Kultura shqiptare ka mbetur krejtësisht e panjohur në botë. E di se ky problem nuk mund të zgjidhet brenda një kohe të shkurtër, por mendoj se ka ardhur koha që të bëhet më shumë për ta paraqitur kulturën shqiptare edhe jashtë kufijve shqiptarë. Tashmë, ndryshe nga situata që mbretëronte para 15 vjetësh, kur Shqipëria ishte e mbyllur, ndërsa Kosova ishte e rrethuar, shqiptarët janë qytetarë të Evropës. Rrjedhimisht, lidhjet ekonomike, kulturore, individuale, etj., janë të shumta, kështu që, detyrimisht, interesimi i evropianëve për shqiptarët dhe kulturën e tyre do të jetë shumë më i madh.

Bota Sot: *Z. Elsie, cilat janë preokupimet momentale si dhe planet tuaja për të ardhmen?*

Robert Elsie: Kam përgatitur një studim dhe përkthim të këngëve të kreshnikëve, i cili shpresoj se do të botohet së shpejti në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjithashtu, kam botuar në Londër një fjalor të besimit popullor shqiptar, domethënë të mitologjisë, të fesë, etj. Tani po përgatis, po ashtu, një dorëshkrim të vjetër, nga shekulli XIX, të historisë së Shqipërisë, të shkruar frëngjisht më 1884. Pra, fjala është për Historinë e parë të Shqipërisë. Përveç kësaj, po përgatis edhe disa përkthime letrare nga gjuha shqipe në gjuhën angleze.

Intervistoi: Xhavit Beqiri.

[botuar në: *Bota Sot*, Prishtinë, 3 shtator 2001, f. 19 / published in: *Bota Sot*, Prishtina, 3 September 2001, p. 19.]